

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

"NOE SH.P.K"

Sot, me datë 22/02/ 2021:

U paraqit personalisht **Z.GENTIAN NIKA**, lindur në Durrës (Shqipëri), me 13/05/1978 dhe banues në lagjen Nr.17, Rruga "Stefan Kaculini", Pallati "Orion Konstruksion", me kartë identiteti me Nr. ID 031347329 dhe Nr.personal H80513066B.

Ka vendosur të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "**NOE SH.P.K**" si më poshtë:

Artikulli 1

Personi i sipërpërmëndur, me vullnetin e tij të lirë dhe me liri të plotë në bazë të ligjeve shqiptare, themelon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) të emërtuar "**NOE SH.P.K**".

Ortaku i vetëm i shoqërisë me nje kuote me 100% pjesemarje ne kapital themeltar me vlerë nominale prej 100 lekësh (Njeqind) eshte:

- **Z.GENTIAN NIKA**, lindur në Durrës (Shqipëri), me 13/05/1978 dhe banues në lagjen Nr.17, Durrës, Rruga "Stefan Kaculini", Kompleksi Orion, me kartë identiteti me Nr. ID 031347329 dhe Nr.personal H80513066B.
- Bazuar në nenin 95 të ligjit 9901 datë 14/04/2008, i sipërpërmënduri **Z.GENTIAN NIKA** është gjithashtu dhe administrator i kësaj shoqërie për një periudhë 5 vjecare e rinovueshme automatikisht.

Shoqëria ka të drejtën të krijojë filiale brënda dhe jashtë vëndit në cdo moment që do të konsiderohet i përshtatshem nga ana e saj dhe me aprovimin e organeve kompetente (Qendra Kombëtare e Regjistrimeve).


Artikulli 2

Shoqëria "**NOE SH.P.K**" gëzon statusin e personit juridik. Aktiviteti i saj do të zhvillohet sipas pikave të paraqitura në këtë akt themelimi, statutit të saj dhe ligjeve në fuqi

Selia e saj është në : Lagjia 17, Rruga Stefan Kaculini, Pallati "Orion Konstruksion", Durrës
Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë integrale e tij.

Shoqëria ka vulën e saj me mbishkrimin "**NOE SH.P.K**."





Artikulli 3


Aktiviteti i shoqërisë si person juridik fillon me miratimin e aktit të themelimit nga ana e organeve shtetërore kompetente dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore më të gjatë se 10 vjet.

Artikulli 4

Shoqëria "NOE SH.P.K" ka si objekt të sajën:

Të veprojë për llogari të vetë apo për persona të tretë, duke respektuar ligjet, si në Republikën e Shqipërisë ashtu edhe jashtë kufijve, të aktiviteteve të pasqyruara më poshtë:

- a) Tregtim me shumice dhe pakice, import-export, marketing të produkteve kozmetike, estetike, higjenike, dietike, ushqimore, medikamente, të materialeve dhe paisjeve mjeksore dhe aksesoreve të tyre, kiteve laboratorike, të lendeve të para të perpunuara për prodhim farmaceutike, e parafarmaceutike, lendeve të gatshme apo gjysem të gatshme kozmetike, estetike dhe higjenike.
- b) Tregti me produkte/pajisje kozmetike, estetike, higjenike apo mjeksore;
- c) Hapje pika shitjesh për tregtim të produkteve estetike, kozmetike apo higjenike;
- d) Zhvillim të aktivitetit kërkimor shkencor në Shqipëri dhe jashtë vendit.
- e) Shoqëria do të kryejë të gjitha veprimtaritë e shitjes së drejtperdrejte të produkteve kozmetike dhe estetike, kremrave, locioneve, fragrancave, parfumeve dhe produkteve të tjera të bukurore produkte të modes, produkte konsumi dhe produkte shtëpiake të të gjitha llojeve, artikuj argjendarie. Prodhimin, reklamimin, shpërndarjen e artikujve kozmetike, estetike, higjenike, dietike dhe mjeksore;
- f) Tregti me shumicë e pakicë, import, eksport brenda dhe jashtë vendit të mallrave industrialë, elektrikë, hidrosanitare, elektroshtëpiake, ushqimore, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, cigare, bujqësore, ndërtimore dhe drusore, shërbime tregtie për bar, bufe, piceri e restorant, transport mallrash të ndryshëm, brenda e jashtë vendit për vetë e të tretë. Hoteleri, agjensi udhëtimesh, dhënie automjete me qera.
- g) Shoqëria, brenda kufijve ligjore, mund të kryejë çdo operacion që lidhet me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, truallë (blerje, dhënie me qera, shitje).
- h) Shoqëria mund të kryejë brenda kufijve ligjore aktivitete të tjera ndihmëse, të ndërvarrura apo në funksion të aktiviteteve të mesipërme;
- i) Shoqëria mund të marrë pjesë në mënyrë të drejtperdrejte ose tërthore në çdo shoqëri që ka objekt të ngjashëm apo që lidhet me objektin e shoqërisë.



- j) Shoqëria mund të kryejë dhe veprimtari të tjera ndihmese të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- k) Shoqëria mund të angazhohet gjithashtu në çdo lloj aktiviteti tjetër që nuk ndalohej me ligj;
- l) Blerje, shitje të aksioneve në shoqëri të të gjitha tipeve, që janë themeluar ose në fazë themelimi që kanë objekt social të njejtë ose të ndryshëm nga objekti social i firmës përfshirë këtu aktivitetet e vlerësimit dhe menaxhimit të këtyre të fundit;
- m) Shërbime të lidhura me asistencën teknike, menaxhuese ose të strategjive të firmave, drejtuese, tregtare dhe administrative.

Artikulli 5

Kapitali i kësaj shoqërie është 100 (Njëqind) lekë, i përbërë nga 1 kuotë me vlerë nominale 100 (Njëqind) lekë.

Ortaku i vetëm i shoqërisë **Z.GENTIAN NIKA**, është zotues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 leke që përben 100% të kapitalit themelues të shoqërisë.

Artikulli 6

Fitimi neto që do të përfitohet nga aktiviteti i kësaj shoqërie, nëse do të shpërndahet, do t'i caktohet ortakëve në bazë të kuotave të pjesëmarrjes që disponojnë në kapitalin e shoqërisë.

Artikulli 7

Për detyrimet ndaj të tretëve që do të krijohen gjatë aktivitetit, shoqëria do të përgjigjet ekskluzivisht vetëm me kapitalin e saj. Për rrjedhojë, ortakët nuk do të kenë asnjë përgjegjësi për detyrimet e krijuara nga shoqëria, përveçse brenda kufijve të kapitalit të vetë shoqërisë.

Artikulli 8

Marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri dhe filialet e saj rregullohen përmes Kontratës së punës.

Artikulli 9

Dispozita më të thelluara mbi organizimin e kësaj shoqërie janë të specifikuar në statutin e shoqërisë.

Themeluesit e shoqërisë e kanë lexuar këtë akt themelimi, e kanë konsideruar të pranueshëm ndaj vullnetit të tyre dhe e kanë firmosur pa kundërshtime.

ORTAKU I SHOQËRISË


GENTIAN NIKA

GENTIAN NIKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER FLORIAN F. HOXHA



DATE 22/02/2021
NR REP 222



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 22.02. 2021 (Dymije e njezet e nje), para meje Noter FLORIAN F. HOXHA, anëtar në Dhomen Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, NR.641, NR.27, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Gentian Nika, atësia Gjergj, amësia Margarita, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Rr. Dalip Peza Lagja 17; Nd. Nr 884; Durrës; Durrës; 2006; Durrës, lindur më 13/05/1978, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031347329 dhe nr. personal H80513066B.

shtetasi i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkruajti përpara meje Noter, "Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqerise **NOE SHPK**, bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, me ane të mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

FLORIAN F. HOXHA